

VENDIM
Nr. 271 , datë 29.4.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.505, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN
E KOMISIONEVE EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39/2, pika 4, e 39/3, pika 5, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a”, e pikës 6, të vendimit nr.505, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Ankimi në komisionin epror bëhet nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, sipas formularit tip të dhënë në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj